



DREJTORIA E ARSIMIT
DIREKCIJA OBRAZOVANJE
DIREKTORATE OF EDUCATION

Tel / Fax _____
Adresa _____
E- mail _____

DATA/DATUM/DATE	03.12.2024.
NR/BR.	07 Nr./ <u>540</u>
PËR/ZA/TO	Publikim të konkursit për ndarjen e bursave për studentë për vitin akademik 2024/2025.
NGA/OD/FROM	Drejtori i Drejtorisë së Arsimit z. Afrim Llabjani
PËRMES/PREKO/THROUGH	Sektorit administrativ të Drejtorisë së Arsimit.
LËNDA/PREDMET/SUBJEKT	Konkurs: për ndarjen e bursave për studentë, për vitin akademik 2024/2025.

Bazuar në nenin 8, paragrafi 1 dhe 3 dhe nenin 10, të Rregullores për ndarjen e bursave për studentë për vitin akademik 2024/2025, Drejtoria e Arsimit shpall:

K O N K U R S

- Për ndarjen e 100 bursave fillestare për vitin akademik 2024/2025.
- Përparësi për fitimin e bursës kanë studentët e degëve deficitare.

Kushtet: Të drejtë për të aplikuar kanë studentët të cilët:

- Janë banorë rezidentë të Komunës së Ferizajt,
- Janë student që studiojnë në universitete të Republikës së Kosovës dhe universitete jashtë shtetit, por jo ata me vetëfinancim, korrespondencë, studentë në studime pasuniversitare Master dhe Doktoratë,
- Janë studentë së paku në vitin e dytë të studimeve themelore- Bachelor,
- Janë studentë të rregullt,
- Studentët të cilët i kanë të përfunduara të gjitha provimet e vitit paraprak,
- Studentët të cilët e kanë të regjistruar vitin akademik për të cilin ndahet bursa.
- Studentët me notën mesatare 7.50 e më të lartë,
- Studentë të cilët nuk kanë humbur dhe nuk janë përsëritës të vitit.

Kriteret për përzgjedhje:

Fëmijëve të Dëshmorëve të Kombit iu ndahet bursa pa kriterë.

Në kushte të barabarta përparësi kanë studentët e familjeve të ngushta të dëshmorëve, invalidëve, pjesëmarrësve të luftës dhe ata me gjendje të vështirë ekonomike-sociale.

Bursa ndahet për dhjetë muaj, nga 50 euro në muaj, gjithsej 500 euro.

Studenti nuk ka të drejtë të marr dy apo më shumë bursa nga njësitë buxhetore apo burime të ndryshme.

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Kërkesa për aplikim,
- Certifikata e provimeve të dhëna (**origjinali**),
- Vërtetimi për dhënien e të gjitha provimeve të vitit paraprak,
- Vërtetimi për regjistrimin e semestrit përkatësisht vitit të rregullt të studimeve 2024/2025,
- Dëshmi se është banorë i Komunës së Ferizajt,
- Deklarata e anëtarëve të familjes,
- Letërnjoftimin personal- kopje,
- Konfirmim për llogarinë e bankës- kopje,
- Vërtetimi nga Administrata Tatimore që nuk janë në marrëdhënie pune;
- Vërtetimin se është fëmijë i dëshmorit, invalidit të luftës, veteranit të luftës, i martirit të luftës, se është person me aftësi të kufizuara, pa prind dhe që është në skemë sociale.
- Diplomë, mirënjohje, certifikatë për suksese të arritura në gara-konkurse kombëtare dhe ndërkombëtare në lëminë e arsimit.
- Nëse vërtetohet se studenti që është përfitues i bursës nga komuna, është duke marrë bursë nga ndonjë njësi tjetër buxhetore, ai/ajo detyrohet të kthejë bursën.

Me rastin e aplikimit studentët me vete duhet të sjellin certifikatën për verifikimin e notave.

Kërkesa për aplikim merret në Zyrën për Shërbimin e Qytetarëve për Drejtorinë e Arsimit në Komunën e Ferizajt.

Dokumentet e pa kompletuara nuk pranohen dhe ato që arrijnë pas afatit nuk merren në shqyrtim nga komisioni.

Konkursi mbetet i hapur **15 ditë** nga dita e publikimit në tabelën e shpalljeve, web faqen e Komunës, respektivisht prej datës: **03.12.2024 deri më 17.12.2024.**